



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 132, datë 21.05.2020

PËR ÇAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës:

V E N D O S I:

1. **Znj. Ollga Visi**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
2. Znj. Ollga Visi do të ushtrojë detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, përkohësisht nga data 24.05.2020-23.08.2020.
3. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Znj. Ollga Visi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SELTI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

